



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësi Org. Org. Jednica Org. Uen	SD-02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	3840-2/25
Nr. i fletëve Broj. listanica No. pages	03	Data Datum Date	21.09.2025
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	15.09.2026
REFERENC-Ë:	25/3870/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Zhuri" SH.P.K. Tranziti p.n. Prizren Shfrytëzim i gurit gëlqerorë në Zhur Prizren
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdim të afatit të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 25/3870/MMPH te dt. 14.05.2025, të operatorit "Zhuri" SH.P.K. Tranziti p.n. Prizren, për vazhdim të afatit të Lejes Mjedisore me nr. nr. 19/1293/197/DMMU, datë: 22.05.2019.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në teren, mbajtjes së debatit publik me qytetar, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

- Vendimi për vazhdim të afatit të Lejes Mjedisore për operatorin "Zhuri" SH.P.K. Tranziti p.n. Prizren, për shfrytëzim i gurit gëlqerorë në Zhur Prizren; dhe
- Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/3870/MMPH
Datë: 15.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 17 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të dt. 24.08.2026, nxjerr këtë

V E N D I M

1. Operatorit "Zhuri" SH.P.K. Tranziti p.n. Prizren, për shfrytëzim i gurit gëlqerorë në ngastrën kadastrale P- 71813026-02829-0, ZK. Zhur Prizren i vazhdohet afati i Lejes Mjedisore.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
- 2.3. Të i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- 2.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjes të gurit gëlqeror;



- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të behët rehabilitimi i zonës së ndikuar;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Leje Mjedisore, vizitës në teren për verifikimin e kushteve mjedisore, mbajtjes së debatit publik me qytetar për operatorin "Zhuri" SH.P.K. Tranziti p.n. Prizren për shfrytëzim i gurit gëlqerorë në ngastrën kadastrale P-71813026-02829-0, ZK. Zhur Prizren, Operatori i plotëson kriteret e parapara në nenin 16 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore dhe nenin 9 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Ky vazhdim i Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje të Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.


Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.